**Republika e Kosovës**

**Republika e Kosovës-Republika e Kosovës**

**Qeveria – Vlada - Government**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministria e Životne Sredine, Prostronog Planiranja i Infrastrukture
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Strehimit/Departament Prostronog Planiranja, Gradnje i Stanovanje/Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Strehimit

# TABELA E VLERËSIMIT DHE SISTEMI I POENTIMIT PËR NËN-PROJEKTET

## RINDËRTIMI I SHTËPIVE PRIVATE PËR FAMILJET APO INDIVIDËT E CENUESHËM

## NË KUADËR TË PROJEKTIT "BANIMI SOCIAL ADEKUAT" NË KOSOVË

## Shtojca 1 e Udhëzuesit të Formularit të Aplikimit

**Komuna: ___________________**

[Për t'u plotësuar dhe vlerësuar nga NjMP / MMPHI]

| 1. KRITERET E PËRGATITJES / Gatishmërisë<br><br>POENTIMI 0-35 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **1.1 Nënkriteret e Vlerësimit – Kapaciteti i NjIP-së<br>Stafi Komunal përgjegjës për Banim/ Shërbime Sociale, NjIP- ja e planifikuar/ Personi (at) Përgjegjës:** | **5/17** | **Poentimi 0-12 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit** |
| **Përshtatshmëria e Burimeve Njerëzore me Përvojë Profesionale të Duhur:** | | **0-7 pikë** | | **Pika 17** |
| Ekipi i projektit përfshin një numër të mjaftueshëm të personelit kyç (së paku: një koordinator projekti, profesionist për çështje sociale/ligjore, inxhinier ndërtimi që mbulon çështjet mjedisore), në përputhje me aktivitetet e propozuara. Stafi kyç posedon përgatitje profesionale të përshtatshme, kualifikime relevante dhe përvojë të mëparshme në role të ngjashme menaxhuese: **7 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Ekipi i projektit përfshin vetëm një pjesë të stafit kyç të nevojshëm, në përputhje me aktivitetet e propozuara. Stafi kyç ka përgatitje profesionale të kënaqshme, kualifikime të përshtatshme dhe përvojë të mëparshme në menaxhimin e roleve të ngjashme:<br>**4-6 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Ekipi i Projektit nuk përfshin numrin e nevojshëm të stafit kyç, në përputhje me aktivitetet e propozuara. Stafi kyç ka përgatitje profesionale, kualifikime dhe përvojë të kufizuar në menaxhimin e roleve të ngjashme: **1-3 pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Numri i anëtarëve të ekipit është i pamjaftueshëm. Stafi kyç ka përgatitje profesionale, kualifikime dhe përvojë të mëparshme të pamjaftueshme në menaxhimin e roleve të ngjashme: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **Përfshirja në projekt:** | | **0-5 pikë** | | **Pika 17** |
| Përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit janë të përcaktuara qartë dhe niveli i angazhimit të tyre (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet /kontraktohet) është i arsyetuar në përputhje me kompleksitetin e Projektit:<br>**5 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit janë të përcaktuara qartë, dhe niveli i përfshirjes së tyre (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet/kontraktohet) është i kënaqshëm dhe i justifikuar në lidhje me kompleksitetin e Projektit: **3-4 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit janë disi të përcaktuara, dhe niveli i përfshirjes së tyre (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet/kontraktohet) është i kufizuar në raport me kompleksitetin e Projektit:<br>**1-2 pikë ( Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit janë të përcaktuara në mënyrë të paqartë dhe niveli i përfshirjes së tyre (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet/kontraktohet) nuk është i justifikuar në raport me kompleksitetin e Projektit: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 1.2 Nënkriteret e Vlerësimit<br>Prokurimi | 5/18 | Poentimi 0-10 pikë | Rezultati përfundimtar | Referenca për pikat e formularit të aplikimit |
|---|---|---|---|---|
| **Kapaciteti i prokurimit** | | **0-5 pikë** | | **Pika 18** |
| Departamenti i prokurimit është me kapacitete të plota dhe përvojë të konsiderueshme në projekte/investime në fushën e banimit ose në fusha të ngjashme: **5 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Komuna ka një departament prokurimi me përvojë të moderuar në projekte ose investime në fushën e banimit apo në projekte të ngjashme: **2-4 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Komuna ka një departament prokurimi me mungesa ose pa përvojë të mjaftueshme në projekte ose investime në fushën e banimit apo në projekte të ngjashme:<br>**0-1 pikë (Nivel i kufizuar/I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **Përshtatshmëria e Burimeve Njerëzore me Përvojë të Mjaftueshme Profesionale:** | | **0-2 pikë** | | **Pika 18** |
| Departamenti ka një numër të mjaftueshëm profesionistësh të caktuar në përputhje me kompleksitetin e projektit. Personeli zotëron përgatitje profesionale të përshtatshme, kualifikime dhe përvojë të mëparshme në menaxhimin e roleve të ngjashme: **2 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Ekipi i projektit përfshin vetëm një pjesë të profesionistëve të nevojshëm, në përputhje me kompleksitetin e projektit. Stafi ka përgatitje profesionale, kualifikime dhe përvojë të mëparshme pjesërisht të përshtatshme në menaxhimin e roleve të ngjashme: **1 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Asnjë anëtar i ekipit nuk është caktuar apo nuk është në dispozicion në përputhje me kompleksitetin e projektit. Stafi nuk ka përgatitje profesionale, kualifikime dhe përvojë të kënaqshme në menaxhimin e roleve të ngjashme: **0 pikë (Nivel i kufizuar/I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **Përfshirja në projekt:** | | **0-3 pikë** | | **Pika 18** |
| Niveli i përfshirjes (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet/kontraktohet) është plotësisht i justifikuar në raport me kompleksitetin e projektit: **3 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Niveli i përfshirjes (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet/kontraktohet) është pjesërisht i justifikuar në raport me kompleksitetin e projektit: **1-2 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Niveli i përfshirjes (me orar të plotë, gjysmë-orar, staf internal, i punësuar, do të punësohet/kontraktohet) nuk është i justifikuar në raport me kompleksitetin e projektit: **0 pikë (Nivel i kufizuar/I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 1.3 Nënkriteret e Vlerësimit<br>Disponueshmëria e shërbimeve kryesore (projektimi, mbikëqyrja, shërbimet e ngjashme) | 5/19 | Poentimi 0-10 pikë | Rezultati përfundimtar | Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 19 |
|---|---|---|---|---|
| Procedurat e prokurimit për të gjitha shërbimet kryesore janë përfunduar dhe kontratat janë nënshkruar: **10 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Procedurat e prokurimit për shërbimet kryesore janë përfunduar pjesërisht, por mund të mos finalizohet në disa raste: **7-9 pikë (Kënaqshëm)** | | | | |
| Procedurat e prokurimit për të gjitha shërbimet kryesore janë iniciuar, por kontratat ende nuk janë nënshkruar: **4-6 pikë (Mirë)** | | | | |
| Procedurat e prokurimit për disa shërbime kryesore janë iniciuar, por progresi është i kufizuar: **3-2 pikë (I kufizuar)** | | | | |
| Procedurat e prokurimit për shërbimet kryesore nuk kanë filluar: **1-0 pikë (Jo efikase)** | | | | |
| **1.4 Nënkriteret e Vlerësimit<br>Disponueshmëria e lejeve/miratimeve kryesore** | **7/25-26** | **Poentimi 0-3 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 25-26** |
| Të gjitha Lejet/Miratimet e marra: **3 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Disa leje/miratime janë marrë, ose procesi është në vazhdim e sipër:<br>**2 pikë (Kënaqshëm)** | | | | |
| Procedurat për marrjen e lejeve/miratimeve kanë filluar, por progresi është minimal: **1 Pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Procedurat për marrjen e lejeve/miratimeve nuk kanë filluar:<br>**0 pikë (E pamjaftueshme)** | | | | |

| 2. KRITERET E EFEKTIVITETIT<br><br>POENTIMI 0-30 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **2.1 Nënkriteret e Vlerësimit**<br><br>**Të dhëna teknike** | **2/7** | **Poentimi 0-25 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 7** |
| **Të dhëna realiste**<br>Disponueshmëria dhe qartësia e informacionit të projektit dhe përfituesve potencial | | **0-3 pikë** | | **7.1** |
| Detaje gjithëpërfshirëse me të dhëna realiste: **3 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Shumica e detajeve të ofruara me të dhëna realiste: **2 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Disa detaje të dhëna, por të dhëna më pak realiste: 1 pikë **(Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Nuk u dhanë detaje realiste: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **Detajet e parametrave kryesorë për rindërtimin e shtëpive private**<br>Përshkrimi dhe detajet teknike të gjendjes ekzistuese | | **0-7 pikë** | | **7.2 / Shtojca 1** |
| Përshkrim dhe detaje gjithëpërfshirëse: **7 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Shumica e detajeve janë ofruar me informacion të plotë: **4–6 pikë (Kënaqshëm deri në Mirë)** | | | | |
| Disa detaje të dhëna, por informacioni është jo i plotë: **1–3 pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Nuk është dhënë përshkrim dhe detaje të plota: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **Disponueshmëria e Infrastrukturës**<br>Qasja në infrastrukturën thelbësore (kanalizime, ujë, energji elektrike, rrugë, telekomunikacion, ngrohje) | | **0-5 pikë** | | **7.2 / Shtojca 1** |
| Qasje e plotë në të gjithë infrastrukturën thelbësore: **5 pikë** | | | | |
| Qasje e pjesshme në infrastrukturën thelbësore: **3-4 pikë** | | | | |
| Qasje e kufizuar në infrastrukturën thelbësore: **1-2 pikë** | | | | |
| Mungesa e qasjes ose boshllëqe të mëdha në infrastrukturën thelbësore: **0 pikë** | | | | |
| **Niveli i Rindërtimit**<br>Lista e Kontrollit Indikativ mbi gjendjen e shtëpisë bazuar në inspektimin vizual | | **0-10 pikë** | | **Shtojca 2** |
| Të dhëna gjithëpërfshirëse për nivelin e rindërtimit dhe listë indikative e plotë e komponentëve: **10 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Shumica e të dhënave për nivelin e rindërtimit janë të ofruara, me disa komponentë në listën indikative: **7–9 pikë (Kënaqshëm deri në Mirë)** | | | | |
| Disa detaje të dhëna, por lista indikative është e pjesshme dhe jo gjithëpërfshirëse: **3–6 pikë (E kufizuar)** | | | | |
| Nuk janë ofruar të dhëna të plota për nivelin e rindërtimit dhe lista indikative mungon: **0–2 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 2.2 Nënkriteret e Vlerësimit<br><br>Zbatimi i Projektit | 3/11 | Poentimi 0-5 pikë | Rezultati përfundimtar | Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 11 |
|---|---|---|---|---|
| Ofron një përshkrim të qartë, të detajuar dhe të strukturuar mirë me të dhëna specifike ose parashikime realiste: **5 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Trajton shumicën e aspekteve të kërkuara, por me detaje të moderuara. Disa fusha mund të kenë mungesë qartësie dhe të dhënash, por përshkrimi mbetet relevant dhe informues: **3-4 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Jep vetëm informacion bazë me detaje minimale. Shpjegimi është i shkurtër, pa specifika dhe nuk tregon plotësisht një zbatim të përshtatshëm:<br>**1-2 pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Përshkrimi është i paqartë, shumë i përgjithshëm ose i mungojnë detaje kyçe. I mungojnë informacione të qarta ose nuk jepet fare: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

| **3. KRITERET E GRUPIT TË SYNUAR/PËRFITUESVE POTENCIALË**<br><br>**POENTIMI 0-10 pikë** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **3.1 Nënkriteret e Vlerësimit**<br><br>**Qartësia, kategorizimi dhe përcaktimi i grupit të synuar:** | **3/9.2** | **Poentimi 0-5 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 9.2** |
| Përshkrim shumë i detajuar: Grupi i synuar është kategorizuar dhe kuantifikuar në mënyrë të qartë dhe të kënaqshme, duke përfshirë të dhëna realiste mbi aspektet demografike, statusin socio-ekonomik, strukturën familjare dhe kushtet aktuale të banimit: **5 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Detajim i moderuar: Grupi i synuar është kategorizuar, por jo në mënyrë të thelluar: **3-4 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Detaje minimale: Grupi i synuar përmendet pa ndarje ose kategori specifike: **1-2 pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Pa detaje ose përshkrim i paqartë: Grupi i synuar përshkruhet në terma shumë të përgjithshëm, pa kategori ose numra të qartë: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 3.2 Nënkriteret e Vlerësimit<br>Ndarja e Përfituesve Potencialë | 3/9.2 | Poentimi 0-5 pikë | Rezultati përfundimtar | Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 9.2 |
|---|---|---|---|---|
| Përshkrim shumë i detajuar: Përfituesit potencialë, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë, janë të kategorizuara dhe të përcaktuara në mënyrë të kënaqshme: **5 pikë** | | | | |
| Detajim i moderuar: Përfituesit potencialë, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë, janë të kategorizuar, por jo me shumë detaje: **3-4 pikë** | | | | |
| Detaje minimale: Përfituesit potencialë, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë, përmenden pa ndarje ose kategori specifike: **1-2 pikë** | | | | |
| Pa detaje ose përshkrim të paqartë: Përfituesit e mundshëm, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë, përshkruhen në terma shumë të përgjithshëm, pa kategori ose numra të qartë: **0 pikë** | | | | |

| 4. KRITERET E RËNDËSISË<br>POENTIMI 0-3 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **4.1 Nënkriteret e Vlerësimit<br>Përputhshmëria me politikat qendrore dhe lokale** | **3/8** | **Poentimi 0-3 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 8** |
| - Përputhje e qartë me politikat komunale dhe kombëtare, me shpjegim realist: **3 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| - Në përputhje me njërën nga politikat komunale ose kombëtare, me një shpjegim të arsyeshëm: **2 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| - Përputhje e pjesshme me detaje të kufizuara: **1 pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| - Mungesë përputhshmërie të qartë ose shpjegim i pamjaftueshëm: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 5. KRITERET E NDIKIMIT<br><br>POENTIMI 0-12 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **5.1 Nënkriteret e Vlerësimit**<br>**Ulja e parashikuar e nevojave/kërkesës për banim tek popullsia e synuar në nevojë** | 6/20 | **Poentimi 0-4 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 20** |
| Paraqet një ulje prej 70% ose më shumë të nevojave/kërkesës së përgjithshme për banim: **4 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Paraqet një ulje prej 70% – 40% të përfituesve të projektit: **2-3 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Paraqet një ulje prej 40% – 10% të përfituesve të projektit: **1-2 pikë (I kufizuar**) | | | | |
| Paraqet një ulje më pak se 10% të përfituesve të projektit: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **5.2 Nënkriteret e Vlerësimit**<br>**Përqindja e parashikuar e përfituesve femra të nënprojektit** | 6/21 | **Poentimi 0-2 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 21** |
| Përfaqëson 50% ose më shumë të përfituesve të projektit: **2 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Përfaqëson më pak se 50% – 10% të përfituesve të projektit: **1 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Përfaqëson më pak se 10% të përfituesve të projektit**: 0 pikë (I kufizuar/I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 5.3 Nënkriteret e Vlerësimit<br><br>Ndikimi Social dhe Ekonomik i Projektit | 6/22 | Poentimi 0-2 pikë | Rezultati përfundimtar | Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 22 |
|---|---|---|---|---|
| Ofron një përshkrim të qartë, të detajuar dhe të strukturuar të ndikimit social dhe ekonomik, duke mbuluar të gjitha aspektet kryesore (përfshirjen sociale, krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe aksesin në shërbimet thelbësore) me të dhëna ose parashikime specifike: **2 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Trajton shumicën e aspekteve të ndikimit social dhe ekonomik, por me detaje të moderuara. Disa fusha mund të kenë mungesë qartësie dhe të dhënash, por përshkrimi mbetet i rëndësishëm dhe informues: **1 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Përshkrimi është i paqartë, tepër i përgjithshëm ose i mungojnë detaje kyçe, nuk e demonstron plotësisht ndikimin e pritur: **0 pikë (I kufizuar/I pamjaftueshëm)** | | | | |
| **5.4 Nënkriteret e Vlerësimit<br><br>Ndikimi në mjedis** | **6/23-24** | **Poentimi 0-2 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 23-24** |
| Ofron një përshkrim të qartë, të detajuar dhe të përshtatshëm të ndikimit në mjedis, duke përfshirë të gjitha aspektet kryesore në komunitetin lokal, ekosistemin dhe habitatin, me të dhëna ose parashikime specifike:<br>**2 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Trajton shumicën e aspekteve të ndikimit në mjedis, por me detaje të moderuara. Disa fusha mund të përmirësohen, por përshkrimi mbetet i rëndësishëm dhe informues: **1 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Përshkrimi është i paqartë,shumë i përgjithshëm ose i mungojnë detaje kyçe dhe nuk e demonstron plotësisht ndikimin e pritur. Mungon informacion i qartë për ndikimin ose nuk ofrohet fare: **0 pikë (I kufizuar/I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 5.5 Nënkriteret e Vlerësimit<br>**Masat për rindërtimin e shtëpive sipas standardeve të përshtatshme kombëtare, projektimin e shtëpive dhe procesin e përzgjedhjes së përfituesve pa diskriminim dhe të ndjeshëm ndaj gjinisë.** | 3/10.2 | **Poentimi 0-2 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 10.2** |
|---|---|---|---|---|
| Ofron një përshkrim të qartë, të detajuar dhe të strukturuar mirë të masave në mbështetje të rindërtimit të shtëpive, duke mbuluar të gjitha aspektet kryesore të përmirësimit të kushteve të jetesës; masa me efikasitet energjetik; zgjidhje banimi të qëndrueshme dhe adaptive ndaj ndryshimeve klimatike; praktika të qëndrueshme mjedisore, me të dhëna specifike ose projeksione:<br>**2 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Adreson shumicën e aspekteve që lidhen me ndikimin mjedisor, por me detaje të moderuara. Disa fusha mund të përmirësohen, por përshkrimi mbetet i rëndësishëm dhe informues : **1 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Përshkrimi është i paqartë, tepër i përgjithshëm, i mungojnë detajet kryesore ose specifikat dhe nuk e demonstron plotësisht ndikimin e pritur. Informacioni për ndikimin është i paqartë ose mungon krejtësisht :<br>**0 pikë (I kufizuar / I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 6. KRITERET E EFIKASITETI<br>POENTIMI 0-5 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kriteret e Vlerësimit<br>Financimi | 4/12-16 | Poentimi 0-5 pikë | Rezultati përfundimtar | Referenca për pikat e formularit të aplikimit: 12-16 |
| Përshkrim shumë i detajuar: Ndarja e kostove sipas burimeve të financimit, kostot e përfshira në buxhet janë të përshtatshme në lidhje me aktivitetet e propozuara dhe rezultatet e pritura dhe kostot e përfshira në buxhet janë të përshtatshme në lidhje me aktivitetet e propozuara dhe rezultatet e pritura. **5 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Detajim i moderuar: Të dhënat ofrohen, por jo me shumë detaje: **3-4 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Detaje minimale: të dhënat përmenden pa detaje dhe ndarje specifike: **1-2 pikë (Nivel i kufizuar)** | | | | |
| Pa detaje ose përshkrim i paqartë: Të dhënat përshkruhen në mënyrë shumë të përgjithshëm, pa detaje dhe ndarje të qarta: **0 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

| 7. KRITERET E PËRMBUSHJES SË DOKUMENTEVE TË KËRKUARA PËR T'I BASHKËNGJITUR FORMULARIT TË APLIKIMIT<br>POENTIMI 0-5 pikë | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteret e Vlerësimit<br>Dokumentet e bashkangjitura** | s.8-9 /f. 22 | **Poentimi 0-5 pikë** | **Rezultati përfundimtar** | **Referenca për pikat e formularit të aplikimit: faqja 22** |
| Plotësisht e përfunduar: të gjitha ose shumica e dokumenteve përkatëse, informacioneve, provave, llogaritjeve dhe tabelave janë dorëzuar/bashkëngjitur: **5 pikë (Shkëlqyeshëm)** | | | | |
| Përfunduar me detajim të moderuar: shumica e dokumenteve përkatëse, informacioneve, provave, llogaritjeve dhe tabelave janë dorëzuar, por jo me shumë detaje dhe përmbajtje: **3-4 pikë (Kënaqshëm deri Mirë)** | | | | |
| Përfunduar minimalisht: disa dokumente përkatëse, informacione, prova, llogaritje dhe tabela janë dorëzuar, por pa detaje dhe përmbajtje: **1-2 pikë (I kufizuar)** | | | | |
| Pa detaje ose e plotësuar në mënyrë të paqartë: shumica e dokumenteve, informacioneve, provave, llogaritjeve dhe tabelave të kërkuara mungojnë, ose nuk kanë detaje dhe ndarje të qarta: **0-1 pikë (I pamjaftueshëm)** | | | | |

**MIRATIMI NGA MMPHI/NjMP**

Pikë totale: ________________

Miratimi:

☐ Po ☐ Pjesërisht (kërkon plotësimin e dokumentacionit/informacionit)

Emri Mbiemri: _________________________ Pozicioni: ________________________________________________________________

Nënshkrimi: _____________________________ Data: _____________________________